

Vendim nr. 74 datë 11.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 11.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ENTON DOGA**, përfaqësuar nga av. Artur Gaxha, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4824 (381), datë 07.06.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 3, 4, 5, 15, 17, 33, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 135, 142 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Enton Doga është një nga trashëgimtarët ligjorë të babait të tij Dh.D. Ky i fundit ka qenë një nga trashëgimtarët e nënës së tij E.D., e cila, nga ana tjetër, ka qenë trashëgimtare e prindërve të saj S.P. dhe K.P. Mbështetur në ligjin nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve”, shtetasja E.D. ka paraqitur një kërkesë për njohjen, kthimin dhe kompensimin e dy pronave, të ndodhura në vendin e quajtur “Gjinovak”, Uji i Ftohtë, Vlorë, respektivisht me sipërfaqe 500 vreten dhe 8 vreten. Për të vërtetuar pronësinë mbi këtë të fundit ajo ka depozituar edhe një vërtetim të Zyrës së Hipotekës Vlorë që bënte fjalë për notën e transkriptimit nr. 96 të datës 06.04.1935, volumi 5, në bazë të së cilës, në radhorin e transkriptimeve të kësaj zyre, në favor të K.P. dhe kundër A.V., është transkriptuar vendimi i datës 04.04.1935 i kryesisë së përmbartimit Vlorë për sekuestrimin ekzekutivisht dhe mandej shitjen në ankand të pasurisë vresht prej 8 vreten, brenda së cilës është një shtëpi përdhese e zotëruar nga A.V., përkundrejt vlerës që i detyrohej K.P. Me vendimin nr. 55, datë 25.10.1994 (*vendimi nr. 55/1994*), Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Vlorë ka disponuar në favor të trashëgimtarëve K.P., A.Ll., A.P. e N.P., duke njohur dhe kthyer çdo pronari në natyrë nga 5000 m² secili, duke i kompensuar në mënyrë të plotë secilit edhe 5000 m², si dhe duke u kthyer në pronësi të dyja banesat që ndodhen në trojet e tyre.

2. Nga ana tjetër, mbi kërkesën e trashëgimtarëve të shtetasit A.V. për njohjen, kthimin dhe kompensimin e një prone me sipërfaqe 60 dynym, të ndodhur në lagjen Uji i Ftohtë, Vlorë, me vendimin nr. 65, datë 23.12.1994 (*vendimi nr. 65/1994*), KKKP-ja, Vlorë ka njohur ish-pronar A.V. për truallin me sipërfaqe 60 dynym, duke kthyer në natyrë sipërfaqet 1200 m² dhe 8800 m², me kufij të përcaktuar.

3. Midis trashëgimtarëve të A.V. rezultojnë të ketë pasur një konflikt gjyqësor, në përfundim të të cilit, me vendimin nr. 41, datë 10.01.1995, Gjykata e Rrethit Vlorë ka vendosur detyrimin e të paditurit (P.V.) të njohë paditësit si bashkëpronarë të truallit me sipërfaqe 6 hektarë (60 dynym), secilin për 1/5 pjesë ose për 1,2 hektarë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në kushtet kur nuk është paraqitur ankim brenda afatit ligjor 10-ditor. Ndërkohë, mbështetur në këtë vendim gjyqësor, në datën 12.01.1995, KKKP-ja, Vlorë ka disponuar për njohjen e pronësisë për truallin prej 6 hektarë (60 dynym) tashmë në favor të 5 trashëgimtarëve të A.V., duke u kthyer atyre në natyrë sipërfaqet 1050 m² dhe 35.078 m², si dhe duke i kompensuar ata për sipërfaqen 23872 m².

Këtij vendimi KKKP-ja, Vlorë i ka vendosur të njëjtat ekstremitete me atë të mëparshmin, pra nr. 65, datë 23.12.1994.

4. Ndërsa kërkesat si më lart kanë qenë për shqyrtim përpara KKKP-së, Vlorë, shtetasja E.D. ka paraqitur padi kundër trashëgimtarëve të A.V. me objekt njohjen pronar për truallin me sipërfaqe 6 hektarë, duke pretenduar se në bazë të dokumenteve hipotekore pasuria e A.V. ishte shitur në ankand në favor të trashëgimtarëve të saj K.P. dhe konkretisht në datën 26.06.1934 ishte shitur gjysma e një kullote prej 1000 vreten, kurse në datën 06.04.1935 ishte shitur vreshti prej 8 vreten. Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, ndërsa KKKP-ja, Vlorë ka marrë edhe vendimin nr. 65/1994 në favor të trashëgimtarëve të A.V., paditësja E.D. ka kundërshtuar gjyqësisht edhe këtë vendim. Fillimisht, me vendimin nr. 2985, datë 11.12.1995, Gjykata e Rrethit Vlorë ka pranuar padinë, duke detyruar të paditurit të njohin paditësen E.D. pronare për 508 vreten tokë me kufij (të vjetër) të përcaktuar, si dhe duke anuluar vendimin nr. 65/1994 të KKKP-së. Ky vendim është prishur dhe çështja është kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 4074, datë 16.08.1996.

5. Në rigjykimin e çështjes trashëgimtarët e paditur të A.V. kanë paraqitur kundërpadi, me të cilën kanë kërkuar anulimin e vendimit nr. 55/1994 të KKKP-së, Vlorë dhënë në favor të trashëgimtarëve të S.P. Me vendimin nr. 564, datë 17.04.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur rrëzimin e padisë dhe të kundërpadisë. Sipas gjykatës, palët ndërgjyqëse kanë fituar të drejta reale të pronësisë sipas vendimeve përkatëse të KKKP-së, për sa ajo ka disponuar për kthimin e tokës. Sipas saj, me vendimin nr. 55/1994, KKKP-ja, Vlorë ka njohur, kthyer dhe kompensuar trashëgimtarët e S.P. vetëm për tokën me sipërfaqe totale 40000 m², të cilën ata e zotëronin. Mbështetur në konkluzionet e ekspertëve të thirrur në gjykim, gjykata ka arritur në përfundimin se pronat e kthyera palëve ndërgjyqëse ishin të ndara midis tyre dhe nuk krijonin mbivendosje, duke mos pasur kështu cenim të ndonjë të drejte pronësie nga asnjëra prej tyre, ndaj ato nuk legjitimoheshin për të kundërshtuar vendimet respektive të KKKP-së, Vlorë. Po ashtu, sipas gjykatës, paditësja E.D. nuk legjitimohej të kërkonte njohjen pronar nga të paditurit për sa kohë vendimi nr. 55/1994 i KKKP-së, Vlorë nuk jepte asnjë indicje për cenimin e ndonjë të drejte pronësie, ndërkohë që ajo nuk provonte të kishte titull pronësie të përfituar në ndonjë nga mënyrat e parashikuara nga ligji për të detyruar palën e paditur që ta njihte pronar. Për këto pretendime

paditësja E.D. mund t'i drejtohej gjykatës për kundërshtimin e vendimit nr. 55/1994 të KKKP-së, Vlorë të dhënë në favor të saj.

6. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 24, datë 27.01.2003, e ka gjetur të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për mungesën e legjitimitetit të palëve ndërgjyqëse në ngritjen e padive respektive, duke u shprehur se nga verifikimi në terren pronat e tyre rezultojnë të ishin të ndara dhe të mos kishte mbivendosje, ndërkohë që edhe në dokumentet e vjetra të pronësisë ato paraqiten si kufitare mes tyre. Për sa u përket pretendimeve të pronësisë së paditëses E.D. dhe atyre në lidhje me përcaktimin e pronës së kthyer dhe asaj të kompensuar me vendim të KKKP-së, Vlorë, gjykata e apelit është shprehur se ky vendim (vendimi nr. 55/1994) është me të meta, të cilat duhet të riparohen në rrugë administrative ose gjyqësore. Mbi rekursin e paditëses E.D., Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1373, datë 01.07.2004, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, duke gjetur të drejtë përfundimin e gjykatave më të ulëta për moslegjitimitetin e palëve ndërgjyqëse për kundërshtimin e vendimeve respektive të KKKP-së, Vlorë. Sipas Kolegjit Civil të paditurit kanë përfituar atë tokë që kanë kërkuar, ndërsa paditësit nuk mund të kundërshtojnë vendimin e KKKP-së, Vlorë të dhënë në favor të të paditurve pa zgjidhur më parë me komisionin e pronave konfliktin lidhur me ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimit nr. 55/1994, për të cilin është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes me kërkesë të tyre.

7. Pas vendimit nr. 24, datë 27.01.2003 të Gjykatës së Apelit Vlorë, shtetasja E.D. ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor me padi me objekt plotësimin e vendimit nr. 55/1994 të KKKP-së, Vlorë, duke njohur pronësinë për tokën me sipërfaqe totale 508 vreten, si dhe duke përcaktuar kufijtë e pronës së kthyer dhe asaj të kompensuar me sipërfaqe 40.000 m². Po ashtu, ajo ka kërkuar edhe anulimin e vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë dhe detyrimin e trashëgimtarëve të A.V. për njohjen pronarë të trashëgimtarëve të S.P. për sipërfaqen e tokës prej 508 vreten. Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje paditësja ka hequr dorë nga gjykimi, shkak për të cilin, me vendimin nr. 265, datë 20.02.2004, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është paraqitur ankim.

8. Ndërkohë, pas vendimit nr. 1373, datë 01.07.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në çështjen më lart (*sipas paragrafit 6 të këtij vendimi*), shtetasi Dh.D. (trashëgimlënësi i kërkuarit) ka vënë përsëri në lëvizje të njëjtin proces gjyqësor për plotësimin e vendimit nr. 55/1994 të KKKP-së, Vlorë etj. Në këtë rast, duke vlerësuar se ligji i ri i pronave nr. 9235, datë 29.07.2004

“Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar (*ligji nr. 9235/2004*) parashikonte mundësinë e verifikimit nga Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës (*KSHKKP*) dhe të drejtën e tij për shfuqizimin e vendimeve të dhëna nga komisionet e mëparshme të pronës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1, datë 01.11.2004, ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim.

9. Në datën 27.04.2005 shtetasi Dh.D. ka paraqitur ankesë përpara *KSHKKP*-së, duke kërkuar ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 55/1994 të *KKKP*-së, Vlorë, si dhe anulimin e vendimit nr. 65/1994 të *KKKP*-së, Vlorë. Në përgjigje të kësaj ankese, me shkresën nr. 1350 prot., datë 27.07.2007, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*AKKP*) i ka bërë të ditur se për pretendimin se *KKKP*-ja, Vlorë kishte harruar të shprehej në vendimin nr. 55/1994 për njohjen e pronësisë për sipërfaqen 508 vreten, si dhe për pretendimin për kthimin e sipërfaqes së tokës sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9235/2004 duhet t’i drejtohej Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*ZRKKP*), Vlorë. Ndërkohë nuk ka ndonjë përgjigje në lidhje me atë pjesë të ankimit ku kundërshtohet vendimi nr. 65/1994 i *KKKP*-së, Vlorë.

10. Më herët, në datën 04.07.2006, shtetasi Dh.D., si përfaqësues i subjekteve të shpronësuara S.P. dhe K.P., i është drejtuar Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë (ndryshuar emërtimin më pas në Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës (*ZRKKP*)), duke i kërkuar plotësimin e vendimit nr. 55/1994 të *KKKP*-së, Vlorë.

11. Krahas kësaj, shtetasi Dh.D. ka paraqitur padi me objekt goditjen për falsitet të vendimit të dytë nr. 65/1994 të *KKKP*-së, Vlorë, padi e cila është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 139, datë 21.01.2008, me arsyetimin se ai nuk legjitimohej për ngritjen e saj në mungesë të një interesi të ligjshëm, referuar për këtë vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 564, datë 17.04.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për ankimin e paditësit Dh.D., me vendimin nr. 360, datë 25.09.2009, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur mospranimin e tij, ndërkohë që nuk ka të dhëna që ndaj këtij vendimi të jetë bërë rekurs.

12. Po ashtu, shtetasi Dh.D. ka paraqitur edhe kallëzim penal për veprën penale “Falsifikimi”, duke pretenduar falsitetin e vendimit të dytë nr. 65/1994 të *KKKP*-së, Vlorë, sikundër dhe të vendimit nr. 24, datë 27.01.2003 të Gjykatës së Apelit Vlorë, në pjesën ku përshkruhet sipërfaqja e kthyer sipas këtij vendimi të *KKKP*-së, Vlorë. Me vendimin e datës

01.10.2008, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pushimin e hetimeve me arsyetimin se nga provat e administruara gjatë hetimit nuk rezulton që këto dokumente të jenë të falsifikuara. Kundër vendimit të pushimit të hetimeve është paraqitur ankim në gjykatë nga shtetasi Dh.D., ankim për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 27, datë 26.05.2009, ka vendosur rrëzimin e tij. Në vijim, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 75, datë 08.04.2010, ka vendosur mospranimin e ankimit të shtetasit Dh.D., vendim për të cilin nuk ka të dhëna që të jetë bërë rekurs.

13. Ndërkohë, ZRKKP-ja, Vlorë ka trajtuar atë pjesë të kërkesës së Dh.D. në themel të së cilës pretendohej pronësia e truallit me sipërfaqe 8 vreten. Me vendimin nr. 396, datë 11.11.2008 (*vendimi nr. 396/2008*), ajo ka vendosur të mos i njohë të drejtën e pronësisë trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar K.P., me arsyetimin se për këtë pronë KKKP-ja, Vlorë është shprehur më herët në favor të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar A.V. Për ankimin administrativ të Dh.D., me vendimin nr. 260, datë 06.08.2010 (*vendimi nr. 260/2010*), AKKP-ja ka vendosur rrëzimin e tij dhe lënien në fuqi të vendimit të ZRKKP-së, Vlorë, duke arsyetuar se trashëgimtarët e K.P. pretendojnë pronësinë për sipërfaqen 9600 m² (8 vreten) mbi bazën e notës së transkriptimit nr. 96 të vitit 1935, ndërkohë që kjo pasuri është trajtuar më parë me vendime të KKKP-së, Vlorë, konkretisht në pjesën më të madhe me vendimin nr. 65/1994 në favor të trashëgimtarëve të A.V., pjesërisht me vendimin nr. 55/1994 në favor të trashëgimtarëve të K.P. dhe me vendimin nr. 32/1994. Sipas AKKP-së, edhe pse vendimet gjyqësore janë shprehur se mes pronave nuk ka mbivendosje, kërkimi i ri për sipërfaqen 9600 m² mbivendoset me pronën e trajtuar me vendimet e mësipërme të KKKP-së. AKKP-ja ka arsyetuar se ajo nuk mund të shprehet për njohje dhe kthim për një sipërfaqe që është trajtuar me vendime të KKKP-së. Në lidhje me atë pjesë të ankimit me të cilin kërkohet prishja e vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë, AKKP-ja ka vlerësuar se i mungon juridiksioni dhe kompetenca për verifikimin e ligjshmërisë së këtij vendimi në kushtet e shfuqizimit të nenit 15, shkronja “d”, të ligjit nr. 9235/2004 nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), me vendimin nr. 27, datë 26.05.2010.

14. Në datën 02.09.2010 trashëgimtarët e E.D. i janë drejtuar gjykatës me padi me objekt anulimin e vendimit nr. 260/2010 të AKKP-së dhe të vendimit nr. 396/2008 të ZRKKP-së, Vlorë, njohjen e së drejtës së pronësisë për truallin me sipërfaqe 9600 m², të ndodhur në Vlorë, me kufizimet përkatëse dhe kthimin e sipërfaqes 9300 m²; anulimin e pjesshëm (të pikës 2) të vendimit

nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë dhënë në favor të trashëgimtarëve të shtetasit A.V. për truallin me sipërfaqe 9300 m² dhe detyrimin e tyre që të njohin pronësinë e paditësve për këtë sipërfaqe; detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Vlorë që të regjistrojë vendimin e gjykatës.

15. Gjatë gjykimit të çështjes një nga paditësit, shtetasi Dh.D., ka ndërruar jetë, shkak për të cilin është bërë kalimi procedural duke u zëvendësuar me trashëgimtarët e tij, konkretisht bashkëshorten dhe fëmijët, ndër ta edhe kërkuesi Enton Doga. Në kushtet kur në gjykim nga paditësit është paraqitur vetëm kërkuesi, gjykimi i çështjes ka vijuar vetëm për të, ndërsa për paditësit e tjerë gjykimi është pushuar.

16. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 10409, datë 21.10.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke: (i) anuluar vendimet nr. 260/2010 të AKKP-së dhe nr. 396/2008 të ZRKKP-së, Vlorë dhe njohur paditësit të drejtën e pronësisë për truallin me sipërfaqe 9600 m², me vendndodhje dhe kufij të përcaktuar; (ii) anuluar pjesërisht vendimin nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë dhënë në favor të trashëgimtarëve të shtetasit A.V. për truallin me sipërfaqe 9300 m², detyrimin e tyre të njohin pronësinë për këtë sipërfaqe në emër të paditësit, si dhe detyrimin e ZVRPP-së, Vlorë të regjistrojë vendimin e gjykatës. Për pjesën tjetër të padisë gjykata ka vendosur rrëzimin e saj. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim trashëgimtarët e paditur të shtetasit A.V.

17. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 3751, datë 13.11.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi trashëgimtarët e paditur të A.V. kanë paraqitur rekurs, mbi të cilin Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4824 (381), datë 07.06.2023, ka vendosur prishjen e vendimeve e dy gjykatave më të ulëta dhe pushimin e gjykimit të çështjes me arsyetimin se në rastin konkret jemi para “gjësë së gjykuar”.

18. Në datën 05.02.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

19. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë i ka cenuar:

19.1. *Të drejtën për proces të rregullt në drejtim të:*

19.1.1. *Së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj në drejtim të parimit të sigurisë juridike, pasi në Gjykatën e Lartë nuk është respektuar procedura e shortit për përbërjen e trupit gjykues dhe caktimin e datës së zhvillimit të gjykimit dhe se në dosjen gjyqësore nuk gjenden të administruara vendimet për shtyrjen e gjykimit, shkakun e shtyrjes dhe caktimin e datës së gjykimit. Seanca është caktuar fillimisht në datën 15.02.2023 dhe gjykimi ka përfunduar në datën 07.06.2023. Ky parim është shkelur edhe për shkak të vendimit të ndërmjetëm për revokimin e vendimit të Kolegjit Civil të asaj gjykate që ka vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, pasi shqyrtimi mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit nuk i ka dhënë mundësinë atij të kuptojë drejt çështjen për vetë kompleksitetin e saj. Shkaku i revokimit është hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore, ndërkohë që ndryshimet procedurale që miratohen gjatë procesit gjyqësor, në përmbajtje të të cilave nuk ka asnjë rregull për efekte prapavepruese, mund të rregullojnë vetëm efektet e paezauruara dhe nuk mund të zbatohen për marrëdhëniet e rregulluara sipas ligjit të kohës.*

19.1.2. *Parimit të paanshmërisë në gjykim, pasi vendimi i revokimit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është nënshkruar edhe nga gjyqtarja M.B. e cila më pas ka dhënë dorëheqjen, që është pranuar nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë dhe ajo është zëvendësuar nga një gjyqtar tjetër. Ky vendim, megjithatë, ka prodhuar pasoja juridike, pasi është bërë revokimi menjëherë pa shpallur çështjen në sistem dhe pa njoftuar palët për përbërjen e trupit gjykues. Edhe pse në dukje një vendim i ndërmjetëm për vetë efektet e tij, ai lidhet në mënyrë të rëndësishme me çështjen.*

19.1.3. *Së drejtës për proces të drejtë, pasi në kundërshtim me udhëzimin e ministrit të Drejtësisë nr. 353, datë 03.09.2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio” (udhëzimi nr. 353/2013), seanca gjyqësore në Gjykatën e Lartë nuk është regjistruar me mjete audio dhe procesverbali është i paplotë e në të mungojnë shkaqet e shtyrjes së gjykimit. Po kështu, para se çështja të gjykohej nga ajo gjykatë, njëri prej të paditurve ka ndërruar jetë dhe të paditurit nuk e kanë deklaruar*

këtë fakt për të bërë zëvendësimin procedural. Gjykata e Lartë, për shkak të kohës së gjatë të kaluar nga vendimi i gjykatës së apelit, kishte detyrimin ligjor të verifikonte nëse palët ndërgjyqëse ishin gjallë ose jo.

19.1.4. *Së drejtës së mbrojtjes dhe të aksesit*, pasi kërkuesi nuk është njoftuar për zhvillimin e gjykimit në datën 07.06.2023 dhe Gjykata e Lartë duhej ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore dhe të dëgjonte pretendimet e kërkuetit.

19.1.5. *Standardit të arsytimit të vendimit në drejtim të zbatimit të gabuar të parimit të “gjësë së gjykuar”*, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese. Në gjykimin e përfunduar me vendimin nr. 1373, datë 01.07.2004 të asaj gjykate nuk është gjykuar në themel dhe nuk i është dhënë përgjigje përfundimtare ligjshmërisë së vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë, por ai u jep të drejtë paditësve që t'i drejtohen komisionit për të qartësuar dhe saktësuar vendimin nr. 55/1994 të KKKP-së. Gjykata e Lartë e ka anashkaluar këtë vendim dhe i është referuar vendimit unifikues nr. 2/2011 që përcakton rastet se kur mund t'i drejtohet një subjekt KKKP-së. Pas 20 vjetësh ajo gjykatë nuk mund të dispononte në kundërshtim me atë çfarë ka vendosur dhe në këtë drejtim “gjë të gjykuar” përbën pikërisht e drejta e fituar e trashëgimtarëve Doga për t'iu drejtuar komisionit për saktësimin e pronës së tyre lidhur me kufijtë sipas disponimit të vendimit nr. 55/1994. Vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe i pazbatueshëm, pasi në rastin konkret nuk mund të kërkohet rishikimi i vendimit nr. 564, datë 17.04.2002, sepse jo vetëm që ka kaluar afati i parashikuar në nenin 496 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), pasi prova e re është zbuluar vite më parë, por edhe sepse ai vendim nuk ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së.

19.1.6. Me të drejtë gjykatat e faktit kanë arsyetuar se prona ka origjinë të vjetër, që provohet me notën e transkriptimit nr. 96 të vitit 1935, sipas së cilës në favor të shtetasës K.P., kundër shtetasit A.V., është transkriptuar vendimi i kryesisë së përmbartimit Vlorë i datës 04.04.1935. Provë tjetër që rrëzon pretendimin e të paditurve është edhe vendimi nr. 136, datë 28.12.2007 i ZRKKP-së, Vlorë që ka vendosur njohjen dhe kthimin e pronës subjektit të shpronësuar M.T., ku në veri

prona kufizohet me atë të trashëgimlënës K.P. (prona prej 8 vreten). Gjykatat e faktit kanë arsyetuar drejt se nuk jemi para “gjësë së gjykuar”, pasi ndonëse jemi para të njëjtave palë, objekti nuk është i njëjtë, pra shkaku i kërimit të pronës nuk është vendimi nr. 55/1994, i cili ka qenë objekt i gjykimeve të mëparshme, por sepse me dokumentet e reja të origjinës së pronës provohet se ka mbivendosje të plotë me pronën që u është kthyer të paditurve me vendimin nr. 65/1994. Edhe vendimet e gjykatës së rrethit nr. 265, datë 20.02.2004 (me objekt plotësimin e vendimit nr. 55/1994 të KKKP-së, Vlorë) dhe nr. 360, datë 26.09.2009 (me objekt goditjen për falsitet të vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë) nuk kanë të njëjtin objekt padie me atë në këtë gjykim.

- 19.2. *Së drejtës së pronës private*, pasi edhe pse formalisht Gjykata e Lartë ka arsyetuar se duhet të përdoret si mjet procedural rishikimi, kjo është e pamundur dhe kërkuetit nuk i mbetet asnjë mundësi tjetër për rivendosjen se kësaj të drejte edhe pse ka faktuar me prova bindëse se është pronar. Gjykata e Lartë e ka shpronësuar *de facto* pa shpërblim, duke çuar në humbjen përfundimtare të pronës së kërkuetit.
- 19.3. Në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000, për shkak se ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Lartë mund t'i shkaktojë dëm të rëndë dhe të pazëvendësueshëm, kërkohet marrja e masës provizore për sigurimin e padisë dhe pezullimi i ekzekutimit deri në përfundimin e gjykimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

20. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve

juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues.

21. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

22. Për sa u përket pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, ai ka pretenduar, mes të tjerash, se para se çështja e tij të gjykohej nga Gjykata e Lartë njëri prej të paditurve ka ndërruar jetë dhe të paditurit nuk e kanë deklaruar këtë fakt për të bërë zëvendësimin procedural. Sipas tij, Gjykata e Lartë, për shkak të kohës së gjatë të kaluar nga vendimi i gjykatës së apelit, kishte detyrimin ligjor të verifikonte nëse palët ndërgjyqëse ishin gjallë ose jo. Kolegji vëren se kërkuesi, si subjekt i kushtëzuar në kuptim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në ç’mënyrë ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese. Në këtë kuptim, për sa i përket këtij pretendimi, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të provojë se si lidhet me cenimin e drejtpërdrejtë të së drejtës së tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, ndërkohë që, në thelb, ai synon mbrojtjen e të drejtave të personave të tjerë në procesin gjyqësor.

23. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

24. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës u bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të

ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

25. Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 07.06.2023, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 05.02.2024. Sipas kërkuarit, ai ka kërkuar vazhdimisht vendimin e arsyetuar pranë Gjykatës së Lartë dhe i është bërë me dije se nuk ishte arsyetuar deri në datën 01.12.2023, kur i është vënë në dispozicion kopje e tij.

26. Me qëllim verifikimin e datës në të cilën vendimi i kundërshtuar është bërë i disponueshëm për palët, Gjykatës së Lartë i është kërkuar informacion për këtë qëllim dhe me *e-mail-in* e datës 21.03.2024 ajo ka informuar se vendimi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 28.11.2023. Duke konsideruar këtë të fundit si datën e marrjes dijeni efektivisht për vendimin e arsyetuar objekt i këtij ankimi, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor, për rrjedhojë kërkuari legjitimohet *ratione temporis*.

27. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj në drejtim të sigurisë juridike, pasi në Gjykatën e Lartë nuk është respektuar procedura e shortit për përbërjen e trupit gjykues dhe caktimin e datës së zhvillimit të gjykimit, si dhe në dosjen gjyqësore nuk gjenden të administruara vendimet për shtyrjen e gjykimit, shkakun e shtyrjes dhe caktimin e datës së gjykimit. Ky parim, sipas kërkuarit, është shkelur edhe për shkak të vendimit të ndërmjetëm për revokimin e vendimit të Kolegjit Civil të asaj gjykate që ka vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, pasi shqyrtimi mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit nuk i ka dhënë mundësinë atij të kuptojë drejt çështjen për vetë kompleksitetin e saj.

28. Referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, Kolegji vëren se pas regjistrimit të çështjes së kërkuarit në Gjykatën e Lartë, fillimisht është caktuar relatore gjyqtarja M.A. dhe në vijim, pas largimit të saj nga detyra, është caktuar relatore gjyqtarja M.B. Me vendimin e datës 26.04.2016, Kolegji Civil i asaj gjykate ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe në vijim, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve procedurale, me vendimin e datës 30.01.2023, kolegji ka vendosur revokimin e atij vendimi dhe shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në datën 15.02.2023, mbi bazë dokumentesh. Me njoftimet e datës 30.01.2023 Gjykata e Lartë ka njoftuar palët ndërgjyqëse për vendimin e revokimit, për shqyrtimin e çështjes mbi bazë dokumentesh, në dhomën e këshillimit, në datën 15.02.2023, si edhe për të drejtën për paraqitjen e pretendimeve me shkrim jo më vonë se pesë ditë përpara datës së caktuar të seancës. Në lidhje me këtë njoftim rezulton që kërkuari Enton Doga të ketë marrë dijeni në datën 31.01.2023.

29. Me vendimin e datës 31.01.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka bërë kalimin procedural të palës së paditur, duke thirrur në gjykim ATP-në dhe ASHK-në. Në datën 06.02.2023, pasi është njohur me kërkesën e kërkuarit Enton Doga për përjashtimin e saj nga gjykimi, gjyqtarja M.B. ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi në kushtet kur, sipas dokumenteve të paraqitura nga kërkuari, rezultonte të kishte marrë pjesë më parë në një gjykim tjetër, në të cilin është shprehur për rrethana dhe fakte që kanë lidhje me objektin e gjykimit dhe palët ndërgjyqëse. Kjo kërkesë është pranuar nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 77 prot., datë 14.02.2023. Për rrjedhojë, në zbatim të vendimit nr. 17, datë 07.07.2022 të Këshillit të Gjykatës së Lartë, pas shortit manual të hedhur në datën 16.02.2023, trupi gjykues është plotësuar me gjyqtarin E.P., ndërkohë që relator i çështjes është përzgjedhur një nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues (gjyqtari D.S.). Me vendimin e datës 03.05.2023, mbi bazën e kërkesës së paraqitur, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka bërë kalimin procedural edhe të atyre trashëgimtarëve të paditur të A.V. për të cilët është verifikuar se kishin ndërruar jetë, duke thirrur në gjykim trashëgimtarët e tyre ligjorë. Në vijim, me shpalljen e datës 23.05.2023, Gjykata e Lartë ka njoftuar shqyrtimin e kësaj çështjeje në dhomën e këshillimit të datës 07.06.2023 dhe sipas procesverbalit të asaj seance rezulton se pasi ka shqyrtuar çështjen, Kolegji Civil ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

30. Kolegji vëren se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, referuar akteve të dosjes gjyqësore, Gjykata e Lartë ka administruar, duke bërë pjesë të dosjes gjyqësore, aktet që kanë të bëjnë me procedurën e shortit për caktimin e trupit gjykues, ashtu edhe shpalljen e datës së seancës gjyqësore. Përtej kësaj, referuar përmbajtjes së pretendimeve të kërkuesit dhe argumenteve ku mbështeten ato, Kolegji vlerëson se kërkuesi, për më tepër, nuk ka arritur as që të parashtrojë ndonjë argument të vlefshëm në drejtim të cenimit të ardhur për këtë shkak në të drejtat e tij kushtetuese.

31. Për sa i përket vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë për revokimin e vendimit të kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, Kolegji vëren se kërkuesi e ka lidhur pretendimin e tij me faktin se ndryshimet procedurale në fuqi nuk përmbajnë asnjë rregull për zbatimin e tyre me efekt prapaveprues, ndaj ato mund të rregullojnë vetëm efektet e paezauruara dhe nuk mund të zbatohen për marrëdhëniet e rregulluara sipas ligjit të kohës. Kolegji vëren se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me parimin *tempus regit processum*, duke zbatuar legjislacionin procedural në fuqi në kohën e shqyrtimit të rekursit, që parashikon shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh ose në seancë gjyqësore në prani të palëve, në varësi të natyrës së çështjes dhe pretendimeve të ngritura. Kërkuesi nuk ka arritur të përcaktojë në mënyrë konkrete se në cilat të drejta procedurale të tij ka ndikuar kjo vendimmarrje e ndërmjetme e Gjykatës së Lartë (për revokimin e vendimit të kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore), duke mos arritur të provojë në aspektin kushtetues cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Për më tepër, kërkuesi ka pranuar se ai është njohur me vendimin e revokimit, i cili i është njoftuar nga Gjykata e Lartë, duke pasur mundësinë të parashtrojë edhe qëndrimin e tij në lidhje me të, gjë të cilën nuk e ka bërë.

32. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe të aksesit, pasi nuk është njoftuar për zhvillimin e gjykimit në datën 07.06.2023 dhe se Gjykata e Lartë duhej ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore, në mënyrë që të dëgjonte pretendimet e tij dhe jo në dhomën e këshillimit. Kolegji, siç është evidentuar edhe më sipër, konstaton se kërkuesi është njoftuar nga Gjykata e Lartë si për vendimin e revokimit të vendimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, për të cilin ka marrë dijeni personalisht, ashtu edhe për zhvillimin e seancave gjyqësore, përmes publikimit të njoftimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në përputhje me parashikimet e KPC-së. Kërkuesi nuk ka pretenduar dhe as nuk rezulton, referuar akteve të dosjes

gjqësore, që të ketë lënë të dhënat elektronike të kontaktit për qëllime të njoftimit të tij nga sekretaria e Gjykatës së Lartë. Ai, gjithashtu, nuk ka ngritur asnjë pretendim në lidhje me njoftimin e rekursit ose pamundësinë e tij për të paraqitur parashtrime në kundërshtim të pretendimeve të parashtruara nga pala e paditur apo për të paraqitur kundërrekurs.

33. Gjykata ka mbajtur qëndrimin se vlerësimi nëse çështja duhet të shqyrtohet në dhomë këshillimi ose në seancë publike u përket vetë kolegjeve të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 38, datë 22.02.2023; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se, më së pari, kjo është një çështje e mënyrës së zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, e cila vlerëson nëse në një çështje të caktuar ekziston ndonjë prej rasteve të parashikuara nga dispozitat e KPC-së për shqyrtimin e saj në seancë gjyqësore në prani të palëve. Nga ana tjetër, forma e gjykimit të çështjes “*në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh*”, pra jo me pjesëmarrjen e palëve, nuk është provuar të ketë sjellë ndonjë pasojë në të drejtat e kërkuarit, për sa kohë ai i ka pasur të gjitha mundësitë të ushtrisë të drejtën e mbrojtjes të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar, qoftë nëpërmjet paraqitjes së kundërrekursit, ashtu dhe përmes paraqitjes së parashtrimeve të tij përpara zhvillimit të seancës gjyqësore.

34. Kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, pasi, sipas tij, vendimi i revokimit është nënshkruar edhe nga gjyqtarja M.B., e cila më pas ka dhënë dorëheqjen. Kolegji vëren se vetëm pjesëmarrja e kësaj gjyqtareje në trupin gjykues që ka dhënë vendimin për revokim nuk është e mjaftueshme në aspektin kushtetues për të provuar cenimin e këtij parimi, për sa kohë që gjatë marrjes së atij vendimi, që ka të bëjë me zbatimin e dispozitave procedurale që rregullojnë procesin në Gjykatën e Lartë, nuk rezulton që ajo të ketë bërë vlerësime që lidhen me themelin e çështjes dhe zgjidhjen e konfliktit mes palëve ose të ketë shprehur ndonjë qëndrim në këtë drejtim. Për më tepër, sikundër më lart u parashtrua, vendimi i revokimit nuk është provuar të ketë sjellë ndonjë pasojë në të drejtat e kërkuarit, ndërkohë që gjyqtarja në fjalë nuk ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka shqyrtuar në themel çështjen e tij. Për rrjedhojë, kërkuari nuk ka arritur të provojë cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, në kuptim të testit subjektiv dhe objektiv të tij.

35. Kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të drejtë edhe për shkak se në kundërshtim me udhëzimin nr. 353/2013 seanca gjyqësore nuk është regjistruar me mjete audio dhe procesverbali është i paplotë e në të mungojnë shkaqet e shtyrjes së gjykimit. Gjykata ka

theksuar se interpretimi dhe zbatimi i ligjit, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues dhe se ajo ndërhyr kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 7, datë 21.02.2023; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuarit ka të bëjë, në thelb, me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, ndërkohë që ai nuk ka arritur të provojë në aspektin kushtetues cenimin e ardhur në të drejtat e tij kushtetuese nga kjo veprimtari e Gjykatës së Lartë.

36. Kërkuari ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e standardit të arsytimit të vendimit në drejtim të zbatimit të gabuar të parimit të “gjësë së gjykuar”, pasi në gjykimin e përfunduar me vendimin nr. 1373, datë 01.07.2004 të Gjykatës së Lartë nuk është gjykuar në themel dhe nuk i është dhënë përgjigje përfundimtare ligjshmërisë së vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë, por ai vendim u jep të drejtë paditësve që t’i drejtohen komisionit për të qartësuar dhe saktësuar vendimin nr. 55/1994 të KKKP-së, Vlorë. Po kështu, ai ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe i pazbatueshëm, pasi në rastin konkret nuk mund të kërkohet rishikimi i vendimit nr. 564, datë 17.04.2002, sepse jo vetëm që ka kaluar afati i parashikuar në nenin 496 të KPC-së, duke qenë se prova e re është zbuluar vite më parë, por edhe sepse ai vendim nuk ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë. Gjithashtu, për shkak të këtij qëndrimi të Gjykatës së Lartë, kërkuari ka pretenduar se është cenuar edhe e drejta e pronës private, pasi në këtë mënyrë ajo gjykatë e ka zhveshur *de facto* nga prona e tij edhe pse ai ka arritur të provojë se është pronar. Në vlerësimin e Kolegjit këto pretendime, për nga përmbajtja dhe natyra e tyre, hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të trajtohen në vijim në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar”.

B. Për cenimin e standardit të arsytimit të lidhur me parimin e sigurisë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar”

37. Kërkuari ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese, pasi në gjykimin e përfunduar me vendimin nr. 1373, datë 01.07.2004

të asaj gjykate nuk është gjykuar në themel dhe nuk i është dhënë përgjigje përfundimtare ligjshmërisë së vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë, por u është njohur e drejta paditësve që t'i drejtohen komisionit për të qartësuar dhe saktësuar vendimin nr. 55/1994 të KKKP-së lidhur me kufijtë sipas disponimit të këtij vendimi. Sipas kërkesit, vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe i pazbatueshëm, pasi në rastin konkret nuk mund të kërkohet rishikimi i vendimit nr. 564, datë 17.04.2002, për shkak se jo vetëm që ka kaluar afati i parashikuar në nenin 496 të KPC-së, duke qenë se prova e re është zbuluar vite më parë, por edhe sepse ai vendim nuk ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë. Sipas tij, me të drejtë gjykatat e faktit kanë arsyetuar se prona ka origjinë të vjetër, që provohet me notën e transkriptimit nr. 96 të vitit 1935, sipas së cilës në favor të shtetas K.P., kundër shtetasit A.V., është transkriptuar vendimi i kryesisë së përbarimit Vlorë i datës 04.04.1935. Po sipas kërkesit, vendimi nr. 136, datë 28.12.2007 i ZRKKP-së, Vlorë, që ka vendosur njohjen dhe kthimin e pronës subjektit të shpronësuar M.T., ka përcaktuar si kufitar të tij në veri pronën prej 8 vreten të trashëgimlënës K.P. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e faktit kanë arsyetuar drejt se nuk jemi para “gjësë së gjykuar”, pasi ndonëse jemi para të njëjtave palë, objekti nuk është i njëjtë, pra shkak i kërkimit të pronës nuk është vendimi nr. 55/1994, i cili ka qenë objekt i gjykimeve të mëparshme, por sepse me dokumentet e reja të origjinës së pronë provohet se ka mbivendosje të plotë me pronën që u është kthyer të paditurve me vendimin nr. 65/1994. Sipas kërkesit, edhe vendimet e gjykatës së rrethit nr. 265, datë 20.02.2004 (me objekt plotësimin e vendimit nr. 55/1994 të KKKP-së, Vlorë) dhe nr. 360, datë 26.09.2009 (me objekt goditjen për falsitet të vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë), nuk kanë të njëjtin objekt padie me atë në këtë gjykim. Sipas tij, Gjykata e Lartë e ka shpronësuar *de facto* pa shpërblim duke çuar në humbjen përfundimtare të pronës.

38. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023; nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të

jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023; nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 19, datë 01.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Po kështu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, i cili nënkupton, mes të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 50, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara, si element i këtij parimi, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Gjykata ka pohuar se siguria juridike nënkupton se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim (*shih vendimet nr. 10, datë 13.02.2017; nr. 23, datë 08.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar kur zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve në mënyrë përfundimtare (*shih vendimin nr. 12, datë 17.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor i formës së prerë është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin, si dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, si një element themelor edhe i gjykimit të drejtë, do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 50, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar (*res judicata*) përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata ka çmuar se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimet nr. 42, datë 27.12.2022; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Kolegji vëren se, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, siç është parashtruar në mënyrë të zgjeruar në rrethanat e çështjes (*shih paragrafët 1-17 të këtij vendimi*), kërkuesi është një nga

trashëgimtarët ligjorë të babait të tij Dh.D., i cili ka qenë një nga trashëgimtarët e shtetasës E.D. dhe kjo e fundit ka qenë trashëgimtare e prindërve të saj S.P. dhe K.P. Me vendimin nr. 55/1994, pavarësisht kërimit të një prone me sipërfaqe totale 508 vreten, KKKP-ja, Vlorë ka disponuar në favor të trashëgimtarëve K.P., A.Ll., A.P. e N.P., duke njohur dhe kthyer çdo pronari në natyrë nga 5000 m² secilit dhe duke i kompensuar në mënyrë të plotë secilin nga ata edhe me 5000 m², pra është shprehur pozitivisht vetëm për pronën me sipërfaqe totale 40000 m².

42. Nga ana tjetër, mbi kërkesën e trashëgimtarëve të shtetasit A.V. për njohjen, kthimin dhe kompensimin e një prone me sipërfaqe 60 dynym, me vendimin nr. 65/1994, KKKP-ja, Vlorë ka njohur ish-pronar A.V. për pronën me sipërfaqe 60 dynym, duke kthyer në natyrë sipërfaqet 1200 m² dhe 8800 m², me kufij të përcaktuar. Në vijim, në përfundim të një procesi gjyqësor mes trashëgimtarëve të A.V., në datën 12.01.1995, KKKP-ja, Vlorë ka disponuar për njohjen e pronësisë për sipërfaqen 6 hektarë (60 dynym), duke u kthyer në natyrë sipërfaqet 1050 m² dhe 35078 m², si dhe duke i kompensuar për sipërfaqen 23872 m². Këtij vendimi KKKP-ja, Vlorë i ka vendosur të njëjtat ekstremite, pra nr. 65, datë 23.12.1994.

43. Shtetasja E.D., në cilësinë e trashëgimtares së K.P., ka paraqitur padi kundër trashëgimtarëve të A.V. me objekt njohjen pronar për sipërfaqen 6 hektarë, duke pretenduar se në bazë të dokumenteve hipotekore pasuria e A.V. ishte shitur në ankand në favor të trashëgimtarëve të saj K.P. dhe, në vijim, ka kundërshtuar edhe vendimin nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë. Kurse trashëgimtarët e paditur të A.V. kanë paraqitur kundërpadi për anulimin e vendimit nr. 55/1994 të KKKP-së, Vlorë. Në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 564, datë 17.04.2002, ka vendosur rrëzimin e padisë dhe të kundërpadisë, duke vlerësuar se palët ndërgjyqëse kanë fituar të drejta reale të pronësisë sipas vendimeve përkatëse të KKKP-së, për sa ajo ka disponuar për kthimin e tokës dhe se, bazuar në konkluzionet e ekspertëve, pronat e kthyera palëve ndërgjyqëse ishin të ndara midis tyre dhe nuk krijonin mbivendosje. Duke mos pasur cenim të ndonjë të drejte pronësie nga asnjëra prej palëve ato nuk legjitimoheshin për të kundërshtuar vendimet objekt të padisë dhe të kundërpadisë. Nga ana tjetër, për pretendimet e ngritura të pronësisë, gjykata është shprehur se paditësja E.D. mund t'i drejtohej gjykatës me padi për të kundërshtuar vendimin nr. 55/1994 të KKKP-së, Vlorë të dhënë në favor të saj.

44. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 24, datë 27.01.2003 të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila e ka gjetur të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë. Mbi bazën e rekursit

të paditëses E.D., Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1373, datë 01.07.2004, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, duke vlerësuar se të paditurit kanë përfituar atë tokë që kanë kërkuar, ndërsa paditësit nuk mund të kundërshtojnë vendimin e KKKP-së të dhënë në favor të të paditurve pa zgjidhur më parë me komisionin e pronave konfliktin lidhur me ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimit nr. 55/1994, për të cilin është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes me kërkesë të tyre.

45. Kolegji vëren, gjithashtu, se shtetasja E.D. ka paraqitur padi në gjykatë për plotësimin e vendimit nr. 55/1994 të KKKP-së, Vlorë, anulimin e vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së Vlorë dhe detyrimin e trashëgimtarëve të A.V. për njohjen pronarë të trashëgimtarëve të S.P. për sipërfaqen e tokës prej 508 vreten, por për shkak se ka hequr dorë nga gjykimi, është vendosur pushimi i tij me vendimin nr. 265, datë 20.02.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili ka marrë formë të prerë.

46. Në vijim, rezulton se mbi bazën e kërkesës së shtetasit Dh.D. (trashëgimlënësi i kërkuarit), me vendimin nr. 396/2008, ZRKKP-ja, Vlorë ka trajtuar atë pjesë të kërkesës në themel të së cilës është pretenduar pronësia e truallit me sipërfaqe 8 vreten, duke vendosur të mos i njohë të drejtën e pronësisë trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar K.P. mbi shkakun se për këtë pronë është shprehur më herët KKKP-ja, Vlorë në favor të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar A.V., duke mos e shqyrtuar kështu në themel pretendimin e ngritur të pronësisë, pavarësisht mënyrës së disponimit. Me vendimin nr. 260/2010, AKKP-ja ka vendosur rrëzimin e ankimit administrativ të shtetasit Dh.D. dhe lënien në fuqi të vendimit të ZRKKP-së, Vlorë, duke parashtruar të njëjtin shkak se ajo nuk mund të shprehet për njohje dhe kthim për një sipërfaqe që është trajtuar tashmë me disa vendime të KKKP-së, përfshirë edhe në favor të trashëgimlënëses së ankuesit. Në lidhje me atë pjesë të ankimit me të cilin kërkohet prishja e vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë, AKKP-ja ka vlerësuar se i mungon juridiksioni dhe kompetenca për verifikimin e ligjshmërisë së këtij vendimi.

47. Trashëgimtarët e E.D. i janë drejtuar gjykatës me padi me objekt anulimin e vendimit nr. 260/2010 të AKKP-së dhe të vendimit nr. 396/2008 të ZRKKP-së, Vlorë, njohjen e së drejtës së pronësisë për truallin me sipërfaqe 9600 m², të ndodhur në Vlorë, me kufizimet përkatëse dhe kthimin e sipërfaqes 9300 m²; anulimin e pjesshëm (të pikës 2) të vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së Vlorë dhënë në favor të trashëgimtarëve të shtetasit A.V. për truallin me sipërfaqe 9300 m² dhe

detyrimin e tyre që të njohin pronësinë e paditësve mbi këtë sipërfaqe; detyrimin e ZVRPP-së, Vlorë që të regjistrojë vendimin e gjykatës. Në lidhje me këtë padi, me vendimin nr. 10409, datë 21.10.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke: (i) anuluar vendimet nr. 260/2010 të AKKP-së dhe nr. 396/2008 të ZRKKP-së, Vlorë dhe njohur paditësit të drejtën e pronësisë për truallin me sipërfaqe 9600 m², me vendndodhje dhe kufij të përcaktuar; (ii) anuluar pjesërisht vendimin nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë dhënë në favor të trashëgimtarëve të shtetasit A.V. për truallin me sipërfaqe 9300 m², detyrimin e tyre të njohin pronësinë për këtë sipërfaqe në emër të paditësit, si dhe detyrimin e ZVRPP-së, Vlorë të regjistrojë vendimin e gjykatës. Për pjesën tjetër të padisë gjykata ka vendosur rrëzimin e saj.

48. Në vendimin e saj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur edhe për prapësimin e të paditurve për qenien në rastin konkret para “gjësë së gjykuar”, duke e gjetur atë të papabuar. Sipas asaj gjykate, është e vërtetë se në rrugë gjyqësore është kërkuar anulimi i vendimeve të KKKP-së, Vlorë, nr. 65/1994 dhe nr. 55/1994 dhe se në përfundim të atij procesi gjyqësor, me vendimin nr. 1373, datë 01.07.2004, Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se të dyja palët nuk legjitimohen të kundërshtojnë vendimet respektive të KKKP-së, Vlorë pa u zgjidhur më parë në komisionin e pronave konflikti lidhur me ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimit nr. 55/1994. Në vijim, ajo gjykatë është shprehur se ndonëse janë të njëjtat palë, objekti nuk është i njëjtë, pasi tashmë kundërshtohet vendimi nr. 260/2010 i AKKP-së dhe vendimi nr. 65/1994 i KKKP-së, Vlorë mbështetur në faktin se sipas dokumenteve të reja të pronës, notës së transkriptimit nr. 96 të vitit 1935, sipërfaqja 8 vreten (ose 9600 m²) ka mbivendosje të plotë me atë të kthyer me vendimin nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë, çka do të thotë se shkak i kërimit të pronës nga paditësi në këtë rast nuk është vendimi nr. 55/1994 i KKKP-së, Vlorë, që ka qenë objekt shqyrtimi në gjykimin e mëparshëm, por vendimi nr. 260/2010 i AKKP-së që ka rrëzuar kërkimin e paditësit për pronën prej 8 vreten. Po ashtu, sipas gjykatës, objekti i çështjes në rastin konkret nuk është i njëjtë as me atë të vendimit nr. 265, datë 20.02.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për plotësimin e vendimit nr. 55/1994 të KKKP-së, Vlorë, as me atë të vendimit nr. 360, datë 26.09.2009 të po asaj gjykate, për goditjen për falsitet të vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë (*shih faqet 13 dhe 14 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

49. Mbi bazën e ankimit të trashëgimtarëve të paditur të A.V., Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 3751, datë 13.11.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e konsideruar të drejtë dhe të bazuar atë. Gjykata e apelit, në të njëjtën linjë arsyetimi si dhe gjykata e shkallës së parë, e ka gjetur të pabazuar pretendimin e ngritur në ankim për qenien para “gjësë së gjykuar” (*shih faqen 12 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

50. Ndërkohë, mbi rekursin e trashëgimtarëve të paditur të A.V., Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4824 (381), datë 07.06.2023, ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe pushimin e gjykimit të çështjes, duke vlerësuar se ato kanë keqinterpretuar parimin e “gjësë së gjykuar” dhe se konkluzionet e arritura prej tyre janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit procedural, nenit 451/a të KPC-së. Sipas Kolegjit Civil, nga vendimet gjyqësore që kanë shqyrtuar mosmarrëveshjet mes palëve ndërgjyqëse, objekt kundërshtimi ka qenë vendimi nr. 65/1994 i KKKP-së, Vlorë në lidhje me pronësinë e A.V. dhe se në të gjitha ato procese është rrëzuar padia e trashëgimtarëve të K.P. kundër trashëgimtarëve të A.V. Në kuptim të parimit të “gjësë së gjykuar”, vendimi i formës së prerë nr. 564, datë 17.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë i shtrin efektet edhe për kërkuuesin Elton Doga, duke qenë trashëgimtar i K.P., ashtu edhe mbi të paditurit si trashëgimtarë të A.V., ndaj në rastin konkret jemi përpara të njëjtave palë, të njëjtit objekt dhe të njëjtit shkak, për rrjedhojë gjykata duhej të vendoste pushimin e gjykimit si një padi që nuk mund të ngrihej. Në vijim, Kolegji Civil ka arsyetuar se për arritjen në përfundimin se nuk jemi para “gjësë së gjykuar”, për arsye se objekti nuk është i njëjtë, gjykatat e faktit nuk kanë analizuar drejt kërkesat e ligjit dhe praktikës unifikuese dhe se bazuar në vendimin unifikues nr. 2/2011 pala paditëse nuk legjitimohej t’i drejtohej sërish AKKP-së, duke qenë se kishte një vendimmarrje të KKKP-së, Vlorë për pronën objekt gjykimi, pikërisht vendimi nr. 65/1994. Në këto kushte, duke qenë se është ky vendimi që ka zgjidhur konfliktin mes palëve, i cili ka qenë më parë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe për kundërshtimin e tij janë zhvilluar disa procese gjyqësore me të njëjtat palë, plotësohen elementet e “gjësë së gjykuar” si për palët, objektin, ashtu dhe shkakun e njëjtë (*shih paragrafët 23 - 34 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

51. Nga ana tjetër, sipas Kolegjit Civil, ndërsa pretendon se sipas notës së transkriptimit nr. 96 të vitit 1935, që nuk është administruar në gjykimet e mëparshme, sipërfaqja prej 8 vreten (ose 9600 m²) ka mbivendosje të plotë me sipërfaqen e kthyer të paditurve me vendimin nr.

65/1994 të KKKP-së, Vlorë, për të realizuar të drejtën e tij subjektive paditësi mund të përdorë vetëm mjetin procedural të rishikimit të vendimit të formës së prerë nr. 564, datë 17.04.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (*shih paragrafin 35 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

52. Kolegji, bazuar në rrethanat si më sipër që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, si dhe referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore që kanë shqyrtuar këtë mosmarrëveshje, vlerëson se Gjykata e Lartë, në kuptim të parimit të “gjësë së gjykuar”, u ka dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të palës paditëse në lidhje me kërkimet e saj, duke iu referuar qëndrimit të mbajtur më parë nga gjykatat në procesin gjyqësor në të cilin ka qenë objekt kundërshtimi pikërisht vendimi nr. 65/1994 i KKKP-së, Vlorë, mbi bazën e pretendimeve për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme të trajtuar prej tij nga ish-pronari A.V. në favor të K.P., trashëgimlënëse e palës paditëse. Gjykata e Lartë, duke analizuar gjetjet e vendimeve të dhëna në përfundim të atij procesi, të cilat kanë marrë formë të prerë në kuptimin “*res judicata*”, si dhe në konsideratë të praktikës gjyqësore të unifikuar, ka arritur në përfundimin se vendimi nr. 65/1994 i KKKP-së, Vlorë nuk mund të bëhet objekt i vlerësimit të organit administrativ, AKKP-së dhe, mbi këtë bazë, të vihet përsëri në lëvizje i njëjti proces gjyqësor për kundërshtimin e atij vendimi, por se pala paditëse duhet të përdorë mjetin e jashtëzakonshëm të ankimit, rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë (*shih vendimin nr. 564, datë 17.04.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*).

53. Kolegji çmon të theksojë se me vendimin nr. 1373, datë 01.07.2004, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në përfundim të një procesi gjyqësor të vënë në lëvizje për shqyrtimin e të njëjtave pretendime, të bazuara mbi të njëjtat prova të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, ka vlerësuar se, bazuar në aktin e ekspertimit të administruar gjatë gjykimit, sipërfaqet e tokës që kanë marrë në fakt të dyja palët ndërgjyqëse në ekzekutim të vendimeve të kundërshtuara të KKKP-së nuk kanë mbivendosje me njëra-tjetrën, ndaj ato nuk legjitimohen për kundërshtimin e atyre vendimeve. Sipas Kolegjit Civil, paditësit nuk mund të kundërshtojnë vendimin e KKKP-së të dhënë në favor të të paditurve pa zgjidhur më parë me komisionin konfliktin lidhur me ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimit nr. 55/1994. Po ashtu, Kolegji vëren se në lidhje me këtë të fundit, edhe pse ai fillimisht është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor, në kushtet kur pala paditëse ka hequr dorë, me vendimin nr. 265, datë 20.02.2004 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pushimin e

gjykimit. Nga sa konstatohet, nuk duket që kërkuesi (trashëgimtarët e K.P.) të ketë vepruar sipas orientimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për të zgjidhur më parë gjyqësisht ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimit nr. 55/1994 të KKKP-së, Vlorë, përmes të cilit kërkesa për njohjen e pronësisë është pranuar vetëm për një pjesë të pronës së pretenduar, çka vetëm në rast pranimit, siç ajo gjykatë është shprehur, do ta legjitimonte atë edhe në kundërshtimin e vendimit nr. 65/1994 të KKKP-së, Vlorë. Për rrjedhojë, nuk duket që të ketë ndonjë ndryshim të situatës juridike aktuale në raport me atë kur mosmarrëveshja mes palëve është zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.

54. Në vlerësimin e Kolegjit, Gjykata e Lartë, në përputhje me rolin e saj *subsidiar*, ka bërë një analizë të plotë të fakteve dhe qëndrimeve të gjykatave të zakonshme përgjatë proceseve gjyqësore mes palëve ndërgjyqëse, për të arritur në përfundimin në lidhje me ekzistencën ose jo të “gjësë së gjykuar”, duke arsyetuar në drejtim të fakteve të vërtetuara dhe së drejtës së zbatueshme në rastin konkret. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e “gjësë së gjykuar” është i pabazuar.

55. Nga ana tjetër, edhe pse orientimi i Gjykatës së Lartë në vendimin e kundërshtuar në lidhje me përdorimin nga kërkuesi të mjetit procedural të rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk duket i njëjtë me atë të dhënë në vetë atë vendim, pra për kundërshtimin më parë gjyqësisht të vendimit nr. 55/1994 të KKKP-së, Vlorë dhe, mbi këtë bazë, edhe të vendimit nr. 65/1994 të atij komisioni, Kolegji vëren se një orientim i tillë i Gjykatës së Lartë në vendimin objekt kundërshtimi nuk vë në dyshim përfundimin e saj për qenien në rastin konkret para “gjësë së gjykuar”, çka është dhe thelbi i pretendimit të kërkuesit. I takon kërkuesit dhe gjykatave të zakonshme të trajtojnë pronësinë e pretenduar nga ai, në atë mënyrë që procesi gjyqësor të jetë në përputhje me kërkesat dhe parimet e procesit civil, si dhe me standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

56. Për sa i përket kërkesës së kërkuesit për marrjen e masës provizore për sigurimin e padisë në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000, me pretendimin se ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Lartë mund t'i shkaktojë dëm të rëndë dhe të pazëvendësueshëm, Kolegji vëren se sipas kësaj dispozite të tilla kërkesa për pezullimin e aktit vendosen nga Mbledhja e Gjyqtarëve ose nga Gjykata në seancë plenare, pra kur vlerësohet se çështja duhet të kalojë për shqyrtim në seancë plenare. Në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes kjo kërkesë nuk mund të merret në shqyrtim.

57. Për sa më sipër, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të lidhur me zbatimin e parimit të gjësë së gjykuar është haptazi i pabazuar.

58. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk përmban shkaqe për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a”, “b” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.